



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijemno/Prilato Received/Dulvery	01-09	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSICK	5063/2022		117	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.646/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.584/2022 të datës 17.06.2022 të ankueses me adresë banimi:

ankesën me numër A.nr.646/2022 të datës 22.07.2022 të ankueses

me adresë banimi:

kundër Vendimit numër:1448 i datës 22.06.2022 të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.09.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.584/2022 e datës 30.06.2022 e parashtruara nga ankuesja dhe ankesa me numër A.nr.646/2022 e datës 22.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër:1448 i Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë i datës 22.06.2022.

Arsyetim

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Ministria e Ekonomisë me datë 19.04.2022 ka shpallur konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" në të cilin ka aplikuar edhe ankuesja

dhe dhe sipas Njoftimit të datës 18.05.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të njëjtat e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, respektivisht i ka plotësuar kushtet dhe kërkesat për ngritje në detyrë, mirëpo Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 22.06.2022 nxjerrë njoftim të ri për përfundimin e verifikimit paraprak ku lista e kandidatëve të cilët e kanë kaluar verifikim paraprak ndryshon, mirëpo ankueset mbeten sërish pjesë e listës të cilat e kanë kaluar verifikimin paraprak.

Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë me datë 22.06.2022 nxjerr shkresën njoftuese përmes të cilës bëhet e ditur se procedura rekrutuese e ngritjes në detyrë për pozitën e shpallur sipas konkursit të datës 19.04.2022 është anuluar sipas Vendimit me numër:1448 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë.

Ankuesja dhe kundër Vendimit me numër:1448 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë përmes të cilit ishte anuluar procedura e rekrutimit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Vendimit me numër:1448 të Sekretares së Përgjithshme është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me kërkesën që vendimi i goditur me këtë padi të anulohet ndërsa procedura e rekrutimit vazhdojë sipas rregullave të përcaktuara ligjore, pasi që ekziston parakushti ligjor për vazhdimin e procedurës së rekrutimit sepse në garë kanë mbetur dy (2) candidate që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Ekonomisë. Ndërsa Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Me datën 11.08.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.74/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune, ndërsa me kërkesë e datës 15.08.2022 të Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit me datë 15.08.2022 ka nxjerrë Vendimin VK.nr.78/2022 sipas të cili ankesa e ankueses me numër A.nr.584/2022 e datës 30.06.2022 është bashkuar me ankesën e ankueses me numër A.nr.646/2022 e datës 22.07.2022 pasi që objekti i shqyrtimit ka qenë i njëjti.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.06.2022 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 18.05.2022 dërguar nga A.M për ankuesen; Njoftimin e datës 22.06.2022 për anulimin e procedurës së rekrutimit; Njoftimin e datës 18.05.2022 për listën e kandidatëve nga verifikimi paraprak; Njoftimin e datës 22.06.2022 për përfundimin e verifikimit paraprak; E-mailin e datës 23.06.2022 dërguar nga A. M për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur në përbërje prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 29.06.2022 dërguar nga ankuesja në Këshilli; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 05.07.2022; Përgjigja në kërkesë e datës 12.07.2022 me numër prot:4035/2022; Konkursin e datës 19.04.2022; Listën e të gjithë aplikantëve; Vendimin e datës 05.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm për fillimin e procedurës së rekrutimit; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 18.05.2022 për

refuzimin e aplikacionit të kandidatit L.O; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 18.05.2022 për refuzimin e aplikacionit të kandidatit S.H; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 18.05.2022 për refuzimin e aplikacionit të kandidatit A.Ll; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 18.05.2022 për refuzimin e aplikacionit të kandidatit B.B; Njoftim e Divizionit të Burimeve Njerëzore të datës 18.05.2022; Vendimin për themelimin e Komisionit për Ngritje në Detyrë i datës 27.05.2022; E-mailin e datës 22.03.2022 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Vendimin me numër:01/492 të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të datës 27.01.2020; E-mailin e datës 25.05.2022 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; E-mailin e datës 16.06.2022 dërguar nga ankuesja për anëtarin e Komisionit znj. A.M; E-mailin e datës 08.06.2022 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej gjashtë (6) faqesh; E-mailin e datës 01.06.2022 dërguar nga për me korrespondencën prej katër (4) faqesh; E-maili i datës 24.05.2022 dërguar për Lista e aplikantëve; Njoftimin e datës 18.02.2022; Njoftimin për përfundimin e verifikimit paraprak i datës 22.06.2022; Njoftimin për përfundimin e verifikimit paraprak i datës 27.05.2022; E-mailin e dërguar nga rkiva për kandidatin Vendimin për refuzimin e aplikacionit –ngritje në detyrë i datës 22.06.2022 me numër:1440; Vendimin e datës 22.06.2022 me numër prot:1448 të Zv/Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë; Njoftimin e datës 22.06.2022 për anulimin e procedurës së rekrutimit; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur si në vijim: Çertifikatën e datës 31.10.2021, Çertifikatën e datës 28.06.2019; Çertifikatën e datës 02.10.2019; Çertifikatën e datës 17.11.2019; Çertifikatën e lëshuar nga ShKÇAK me shifër ABC-091; Çertifikatën e datës 02.06.2021; Çertifikatën e datës 06.03.2019; Çertifikatën e datës 07.07.2014; Çertifikatën e datës 24.01.2019; Çertifikatën e datës 10.11.2018; Çertifikatën e datës 19.02.2018; Çertifikatën e datës 04.05.2015; Çertifikatën e datës 28.10.2016; Çertifikatën e lëshuar nga NDI në nëntor 2016; Çertifikatën e datës 25.08.2017; Çertifikatën e lëshuar nga OEK dhe ËKO e muajit dhjetor 2017; Çertifikatën e muajit maj 2015 lëshuar nga OEK dhe ËKO; Diplomën e datës 03.10.2010 me numër;; Diplomën e datës 04.10.2007 me numër:326; Formularë për vlerësimin e rezultateve në punën për vitin 2019, 2020 dhe 2021; Ndryshimi dhe plotësimi Aktit të emërimit i datës 14.06.2017; Akt emërimi i datës 03.03.2014; Çertifikatën e datës 23.09.2013; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.08.2010 me kodin e mirësjelljes së bashkangjitur i datës 02.08.210; Kodin e mirësjelljes së bashkangjitur i datës 02.08.210; 31.12.2009; Kontratën e punës 01.01.2010; Kontratën e punës të datës 20.07.2009; Akt emërimit e datës 01.01.2012; Çertifikatën e datës 11.08.2010; Çertifikatën e lëshuar nga GIZ të muajit maj 2013; Çertifikatën e datës 26.01.2013; Çertifikatën e lëshuar nga KAMS dhe KRM e vitit 2013; Çertifikatën e datës 07.09.2012; Çertifikatën e lëshuar nga BSC; Çertifikatën e datës 07.07.2009; Çertifikatën e datës 14.03.2012; Çertifikatën e datës 30.03.2012; Çertifikatën e datës 02.07.2012; Çertifikatën e datës 03.09.2009; Çertifikatën e datës 13.03.2014; Çertifikatën e datës 17.06.2009; Çertifikatën e datës 18.06.2009; Çertifikatën e datës 25.09.2018; Çertifikatën e datës 18.05.2011; Çertifikatën e datës 08.12.2013; Çertifikatën e lëshuar nga Neë Age School; Çertifikatën datës 13.03.2014; Çertifikatën e datës 03.09.2009; Çertifikatën e lëshuar nga CEBD; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionin e kandidatës si në vijim: Diplomën e datës 15.04.2013 me numër:022/13; Diplomën e datës 10.06.2002 me numër:210; Çertifikatën e avancuar profesionale për prokurim me numër:427; Çertifikatën e datës 03.12.2019; Çertifikatën e datës 22.02.2012; Licencën e datës 21.04.2016; Çertifikatën e muajit dhjetor 2016 të lëshuar nga IPV; Çertifikatën e datës 18.06.2002;

Çertifikatën e datës 15.09.2011; Çertifikatën e datës 13.02.2001; Kopjen letërnjoftimit të kandidatës Formularët për Vlerësimin e Rezultateve në punë; Diplomën e datës 10.06.2002 me numër:210; Diplomën e datës 15.04.2013 me numër:022/13; Dëshminë e datës 19.04.2022; Vërtetimin e punës të datës 06.03.2018; Referencën e datës 24.12.2007; Referencën e datës 10.12.2009; Referencën e datës 04.04.2007; Letër rekomandimin e dhënë nga Drejtori i DAB; Çertifikatën e datës 06.03.2006; Çertifikatën e datës 18.06.2002; Çertifikatën e avancuar profesionale për prokurim me numër:427; Çertifikatën e lëshuar nga CIPFA e periudhës shtator 2011; Licencën profesionale për Auditor të Brendshëm e datës 21.04.2016; Shkresën konfirmuese e datës 02.06.2005; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur si në vijim: Diplomën e datës 16.01.2012 me numër:2927; Çertifikatën e datës 09.10.2020; Çertifikatën e datës 10.07.2009; Çertifikatën e lëshuar nga OSCE dhe ICITAP KOSOVO e vitit 2007; Çertifikatën e datës 24.11.2005; Çertifikatën për Auditimit të Brendshëm e datës 10.11.2017; Çertifikatën e datës 12.07.2002; Çertifikatën e datës 27.04.2005; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 09.11.2018; Akt emërimit e datës 18.05.2021; Letër referencën e datës 12.02.2002; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punës të datës 04.02.2021 dhe datës 28.04.2022; Ankesën e ankueses të parashtruar në Këshill me datës 21.07.2022 përmes e-maili e cila në Këshill është protokolluar me datë 22.07.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.08.2022; Vërtetimin e përvojës së punës i datës 11.05.2021; Vendimin VK.nr.74/2022 i Kryetari i Këshillit i datës 11.08.2022, Vendimin VK.nr.78/2022 i Kryetari i Këshillit i datës 15.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses dhe është e pabazuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se në konkursin e datës 19.04.2022 të shpallur nga Ministria e Ekonomisë për pozitën *Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)*, kanë aplikuar gjithsejtë shtatë (7) shtatë kandidatë, ndërsa sipas njoftimit fillestar të datës 18.05.2022 me numër prot:1122 dhe njoftimit për përfundimin e verifikimit paraprak të datës 27.05.2022 me numër protokoli:1248 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, tre (3) prej tyre i kanë plotësuar kriteret e konkursit në mesin e tyre edhe ankueset dhe mirëpo pas opinionit ligjor nga Zv/Drejtori i Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë me datë 22.06.2022 ka nxjerrë vendimin me numër:1440 përmes të cilit kandidatit Imer Raçi i refuzohet aplikacioni i datës 11.05.2022.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë me datën 22.06.2022 ka nxjerr vendimin me nr.1448 me të cilin ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën: *“Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)”* ngritje në detyrë i publikuar me datë 19.04.2022, me arsyetimin se, citoj: *“Me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë dhe për shkak të verifikimit paraprak të kandidatëve, lidhur me kërkesat e përgjithshme formale për paqartësitë juridike në procesin e verifikimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi u vendos si në dispozitat e këtij vendimi”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së kërkesave të përgjithshme formale në kuptim të kualifikimeve të posaçme formale të paraqitura në konkursin e datës 19.04.2022 me numër të referencës: RN00008764 lidhur me kriteret e përcaktuara për Çertifikatat e lëshuara për titullin Auditor i Brendshëm në sektorin publik, citoj: *“Të jetë i certifikuar nga çertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose Çertifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendos në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve”,* ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nën 53 paragrafi 1 dhe 4 ku përcaktohet se: *“1. Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet, 4. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për ngritjen në detyrë”,* ndërsa në shkresat e lëndës respektivisht e-mailit të datës 06.06.2022 dërguar nga Departamenti Ligjor i Ministrisë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Udhëheqësen e Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se, *citoj korrespondencën: “...Departamenti ligjor ka konstatuar se nuk kemi kritere të përcaktuara me akt nënligjor nga Ministria, që vendosin kornizën mbi të cilën bëhet pranimi i certifikatave nga institucionet tjera vendore apo ndërkombëtare për qëllimet e përcaktuara në nenin 22 të Ligjit-kualifikimet e nevojshme të auditorëve të njësisë së auditimit të brendshëm...”* dhe po ashtu në shkresat e lëndës sipas vendimit me numër: 01/42 të nxjerrë nga Kryetari i KD së Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve i nxjerrë me datë 27.01.2020 përmes të cilit *“Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës- ShKÇAK”* është ri-akredituar si në pikën 5 të këtij vendimi-Auditor i Çertifikuar në Sektorin Publik, si rrjedhojë njëri nga kandidatit I.R posedon Çertifikatën me shifër ABC-091 të lëshuar nga Shoqata e kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës i cili fillimisht e kishte kaluar verifikimin paraprak sipas njoftimit të datës 18.05.2022, mirëpo pas opinionit ligjor të dhënë përmes e-mailit të datës 08.06.2022 nga Zv/Drejtori i Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Udhëheqësen e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë, kjo e fundit me datë 22.06.2022 kishte nxjerr vendimin me numër prot:1440 përmes të cilit kandidatit Imer Raçi i kishte refuzuar aplikacionin me arsyetimin se sipas opinionit ligjor të Zëvendës Drejtorit të Departamentit Ligjor të MFPT-së, çertifikatat për auditor të lëshuar nga ShKÇAK vlerësohet se nuk e përmbushin kushtin e përcaktuar në nenin 22 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-0221 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, andaj mbi bazën e këtyre të gjeturave, Kolegji i Këshillit vlerëson se tek pjesa e kërkesave të kualifikimeve të posaçme formale ka paqartësi të shumta pasi që fillimisht nga Departamenti Ligjor i MFPT-së është theksuar fakti se nuk ka akt nën ligjor që përcakton kriteret mbi të cilat bëhet pranimi i certifikatave nga institucionet tjera vendore apo ndërkombëtare për qëllimet e përcaktuara në nenin 22 Ligjit Nr.06/L-0221 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, ndërsa në rastin e dytë sipas opinion ligjor të datës 08.06.2022 kishin konstatuar se Çertifikatat për auditor të brendshëm e lëshuara nga *“Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës- ShKÇAK”* kanë fushëveprim vetëm ndaj shoqërive tregtare referuar Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, paqartësi këto të cilat shërbejnë si fakt relevant për anulimin e këtij konkursi, ndërsa institucioni punëdhënës respektivisht Ministria e Ekonomisë me rastin e shpalljeve të konkurseve tjera të natyrës së ngjashme duhet t’i eliminojë këto të gjetura dhe t’i përcaktojë qartë specifikat e përcaktuara ligjërisht lidhur me kontestin në fjalë.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" nga Ministria e Ekonomisë, ka analizuar dispozitat Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 39 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 dhe 5.2 si dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 59 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se: "2. KVND themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ; 3.KVND ka në përbërje këta anëtarë: 3.1. një përfaqësues i Njesisë Përgjegjëse (DMZP-ja për institucionet e administratës shtetërore apo Njësia e Burimeve Njerëzore të Institucionit për institucionet e tjera shtetërore) i specializuar në teknikat e përzgjedhjes. 3.2. një përfaqësues nga NJBNJ e vetë institucionit që ka pozitën e lirë; 3.3. një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes", ndërsa në bazë të Vendimit të datës 30.05.2022 me numër protokolli:1256 të nxjerrë nga Zv/Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se është themeluar Komisioni për Vlerësimin e Ngritjes në Detyrë dhe ka pasur këtë përbërje: "1.1 Drejtor-Agjencia e Kosovës për Akreditim Kryesues

Zëvendësueses e Sekretarit të Përgjithshëm të ME-së Zëvendësuese; 1.2

Zyrtare e Lartë për Politika DMZP

Zyrtar për Politika të Burimeve

Njerëzore-DMZP zëvendësues; 1.3

Udhëheqëse e DBNJ, Anëtare-

Zyrtare e Lartë e Personelit DBNJ, zëvendësuese", andaj mbi këtë bazë Kolegji

konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Ngritjes në Detyrë është themeluar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 39 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 dhe 5.2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pasi që dispozitat e përcaktuara si më lartë nuk e specifikojnë themelimin e një komisioni me anëtarë zëvendësues.

Andaj, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve se Vendimi i datës 22.06.2022 me numër protokolli:1448 i nxjerrë nga Zv/Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë për anulimin e procedurës së rekrutimit ngritje në detyrë-avancim për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" duhet të anulohet për shkak të paligjshmërisë së tij dhe se procedura e rekrutimit duhet të vazhdojë, Kolegji i Këshillit në kuptim të nenit 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankinuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankinuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankinuar", vlerëson se vendimi i kontestuar është i ligjshëm mirëpo arsyetimi i përdorur në këtë vendim nuk është i plotë, pasi që arsye shtesë mbi bazën e të cilave kjo procedurë është dashur të anulohet janë edhe konstatimet e pasqyruara në arsyetimin e këtij vendimi lidhur me themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Ngritjes në Detyrë në kundërshtim me nenin 59 paragrafin 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe paqartësive me rastin e kërkesave të përgjithshme formale të paraqitura në konkursin e datës 19.04.2022 me numër të referencës: RN00008764 lidhur me kriteret e përcaktuara për Çertifikatat e lëshuara për titullin Auditor i Brendshëm në sektorin publik, respektivisht këto dy konstatime të dhëna në këtë vendim shërbejnë si plotësim i arsyetimit të Vendimit të datës 22.06.2022 me numër protokolli:1448 të nxjerrë nga Zv/Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë për anulimin e procedurës së rekrutimit ndërsa i njëjti mbetet në fuqi, ndërsa ankesa e ankueseve

A.nr.584/2022 e datës 30.06.2022 si dhe ankesa e ankueses A.nr.646/2022 e datës 22.07.2022 refuzohen si të pabazuara, rrjedhimet pretendimet e tyre ankimore për vazhdimin e procedurë së rekrutimit janë të pabazuara ngase nuk mund të vazhdohet procedura e rekrutimit përderisa Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ka pasur shkelje të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, shtuar faktin kësaj edhe paqartësisë lidhur me kërkesat e posaçme formale për Çertifikatat e Auditimit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se, meqenëse procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" të shpallur nga Ministria e Ekonomisë është anuluar për shkak të konstatimit të shkeljeve ligjore lidhur me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, procedura e rekrutimit e filluar sipas Vendimit të datës 05.04.2022 me numër protokolli:789 të nxjerrë nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme, nuk mund të llogaritet e konsumuar në kuptim të nenit 39 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht procedura e rishpallur nga Ministria e Ekonomisë duhet të jetë përsëri konkurs për ngritje në detyrë-avancim.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.646/2022

Elakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve.
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.

